

Gjyqësori në fokus të RPU-së: nga rekomandime në zbatim



Zhvillimi i vazhdueshëm profesional për gjyqtarët dhe prokurorët publikë për çështje të tilla si dhuna ndaj grave dhe fëmijëve (Hungari);



Të sigurohet trajnim i detyrueshëm dhe zhvillimi i kapaciteteve për anëtarët e gjyqësorit dhe të policisë, me qëllim promovimin e një qasjeje të bazuar në të drejtat e njeriut dhe të përqendruar tek viktimat në trajtimin e dhunës me bazë gjinore (Irlandë);



Të zhvillohen dhe zbatohen kurse trajnimi për policinë, prokurorinë dhe gjyqësorin lidhur me zbatimin e Kodit Penal të ndryshuar së fundmi, i cili përfshin krime të reja dhe përkufizime të reja të dhunës me bazë gjinore dhe dhunës ndaj grave (Panama);



Të ofrohet trajnim për gjyqësorin dhe policinë mbi dhunën me bazë gjinore, duke përdorur një qasje të bazuar në të drejtat e njeriut dhe të përqendruar tek viktimat, me qëllim zbatimin efektiv të Ligjit për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Dhuna ndaj Grave dhe Dhunës në Familje të vitit 2021 (Portugali);



Të sigurohen fonde dhe kapacitete të mjaftueshme për zbatimin efektiv të legjislacionit për dhunën ndaj grave dhe dhunën në familje, si dhe të përmirësohen kapacitetet e strehimit dhe të ofrohen shërbime të specializuara për viktimat, veçanërisht në zonat rurale (Slloveni);




Të forcohen kapacitetet e gjyqësorit dhe të policisë për të luftuar dhunën me bazë gjinore, duke përdorur një qasje të bazuar në të drejtat e njeriut dhe të përqendruar tek viktimat (Luksemburg).

Në ç'masë gjyqtarët dhe prokurorët publikë mendojnë se trajnime mbi antidiskriminimin, dhunën me bazë gjinore dhe mekanizmin e Rishikimit Periodik Universal janë të nevojshme?



Nga trajnimet e mbajtura në maj dhe qershor 2025:

81.82% e pjesëmarrësve besojnë se trajnimi ishte i dobishëm për përmirësimin e njohurive të tyre.



Infografiku "Gjyqësori në fokus të RPU-së: nga rekomandime në zbatim" u zhvillua me mbështetjen e projektit rajonal SMART Balkans: Shoqëria civile për vlera të përbashkëta në Ballkanin Perëndimor, të zbatuar nga Qendra për Promovimin e Shoqërisë Civile (CPCD), Qendra për Kërkim dhe Hartim Politikash (CRPM) dhe Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim (IDM), dhe mbështetet financiarisht nga Ministria e Punëve të Jashtme e Mbretërisë së Norvegjisë. Përmblajtja e infografikut është përgjegjësi e vetme e implementuesëve të projektit dhe nuk pasqyron domosdoshmërisht pikëpamjet e Ministrisë së Punëve të Jashtme të Mbretërisë së Norvegjisë.